



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.303/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur lidhur me ankesën e BIRN/IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Skenderaj, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit me vendosjen e postereve në afërsi të qendrës së votimit 100 m, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.303/2017 e datës 12.06.2017, me të cilën është pretenduar se kandidati për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka thyer heshtjen zgjedhore me vendosjen e posterëve në afërsi të qendrës së vendvotimit, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, BIRN/IKS, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, kandidati për nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka vazhduar me vendosjen e posterave në largësi më të vogël se 100 m, nga qendra e vendvotimit “Hamëz Jashari”, në Skenderaj edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, në bazë të nenit 36 të LZP-së.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjendet në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se në afërsi të shkollës “Hamëz Jashari”, në Skenderaj, monitoruesi i tyre kane hasur një poster reklamuese të kandidatit për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, të ngjitur në hapësirë publike dhe në afërsi të shkollës më pak se 100 metra nga qendra e votimit

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar e ka shkelur heshtjen zgjedhore me vendosjen e posterve në afërsi të vendvotimit. Sepse nga fotoja e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se është shkolla “Hamëz Jashari” dhe nëse e njëjta është duke u shfrytëzuar për të votuar si Qendër e Votimit, në ditën e votimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.303 /2017 më datën 13.06.2017

Kryesuesi i Panelit

Fejzullah Rexhepi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.